REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
Nr. 01-111/01-13227 Datë: 18.06.2020
Gjakovë

Duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës numër 03/L-212, nenit 17 paragrafi 1 te Ligjit numër 04/L-106 për Teatrot, dhe Udhëzimit Administrativ (MPMS) numër 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Komuna e Gjakovës bën:

SHPALLJE E KONKURSIT PËR REKRUTIM

Njësia: DKRS, Teatri i Qytetit "Hadi Shehu"

1. Titulli i vendit të punës: Tonist / Mjeshtër zërimi / Rekuizitor
Niveli i pagesës: sipas koeficientit 6.0
Numri i ekzekutuesve: 1 (një)
Orari i punës: i plotë, 40 orë në javë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kontrollon dhe mirëmban të gjitha stabilimentet radio-fonike dhe rekuizitat në teatër bashkë me audio-mikseten dhe kabllot e nevojshme gjatë gjithë kohës;
- Përgatit komponentët muzikore, akustike-tonike dhe rekuizitat e shfaqjes sipas udhëzimeve të regjisorit apo organizatorit të eventit;
- Përcjell provat dhe bashkë me regjisorin bënë harmonizimin dhe sinkronizimin e interpretimit artistik te elementeve muzikore - tonike dhe efekteve zanore;
- Regjistron të gjitha efektet e mundshme gjatë provave dhe manipulon me aparaturën në mënyrë efikase gjatë provave teknike dhe gjatë shfaqjeve;
- Udhëheq me stabilimentet edhe gjatë kohës kur ansambli gjendet në teren si mysafir;
- Ruan inventarin e regjistruar në librat e regjistrimit për të cilin ngarkohet dhe mban përgjegjësi;
- Mirëmban dhe përcjell zërimin dhe efektet audio-teknike gjatë të gjitha shfaqjeve sipas orarit / kalendarit që caktohet nga teatri;
- Propozon dhe përzgjedhë muzikën eventuale të shfaqjeve në bashkëpunim me regjisorin në mungesë të kompozitorit të shfaqjes;
- Monton dhe demonton pajisjet në rast kërkesave dhe udhëtimeve të shfaqjes dhe siguron që ato mund të transportohen në mënyrë të sigurt.
- Kryen dhe punë të tjera sipas kërkesës së drejtorit të teatrit apo drejtorit për kulturë, rini dhe sport në përputhje me natyrën e punës dhe përgatitjen e tij;
- Për punën e tij i përgjigjet regjisorit, inspicientit, udhëheqësit të njësisë teknike, udhëheqësit artistik dhe drejtorit të teatrit.

Shkollimi i kërkuar: Diplomë e shkollës së mesme.

Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera:

- Të ketë së paku 3 vite përvojë pune aktive në teatër si tonist duke dëshmuar përvojën;
- Njohja e punës praktike me miksetën digjitale të zërimit;
- Njohja e punës praktike me programet kompjuterike të nevojshme për këtë pozitë.

2. Titulli i vendit të punës: Biletashitës
Niveli i pagesës: sipas koeficientit 6.0
Numri i ekzekutuesve: 1 (një)
Orari i punës: i plotë, 40 orë në javë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Bënë rezervimin dhe shitjen e biletave të shfaqjeve të teatrit;
- Identifikon dhe mban përgjegjësi për numrat serik të biletave;
- Vendos numrat e ulëseve në biletat e teatrit sipas numrave të karrigeve në sallë;
- Përpilon raportin e shtijës së biletave së bashku me organizatorin e teatrit;
- Kryen dhe punë të tjera sipas kërkesës së drejtorit të teatrit apo drejtorit për kulturë, rini dhe sport në përputhje me natyrën e punës dhe përgatitjen e tij;
- Për punën e tij i përgjigjet drejtorit të teatrit.

Shkollimi i kërkuar: Diplomë e shkollës së mesme.

Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera:

- Të ketë së paku 3 vite përvoje pune aktive në teatër duke dëshmuar përvojën.

3. Titulli i vendit të punës: Mjeshtër Skene - Shtëpiak
Niveli i pagesës: sipas koeficientit 6.0
Numri i ekzekutuesve: 1 (një)
Orari i punës: i plotë, 40 orë në javë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ndihmon në realizimin e elementeve të skenografisë dhe dekorit sipas udhëzimeve të skenografit;
- Bën montimin dhe demontimin e skenografisë dhe të rekuizitave skenografike në skenë, në seli dhe jashtë saj, për shfaqjet e Teatrit të Qytetit "Hadi Shehu" dhe ndihmon në realizimin e skenografive të shfaqjeve mysafire;
- Kujdeset për mirëmbajtjen e ndërtesës se teatrit për pjesët e brendshme dhe të jashtme;
- Bën mirëmbajtjen themelore të instalimit elektrik, ujit, inventarit dhe pajisjeve të tjera sipas njohurive praktike të tij;
- Në rast të defekteve të mëdha, mban kontakte me ekipet e specializuara dhe asiston me rastin e riparimeve;
- Monton dhe demonton praktikabllat, skenografin dhe ulëset tjera të nevojshme sipas koncepteve të regjisorit apo të te gjitha shfaqjeve që luhen në forma të ndryshme kamertale në çdo hapësirë të kërkuar;
- Bën përgatitjen e elementeve skenografike për shfaqjen qe është në repertor apo për prova gjatë procesit të punës sipas nevojave dhe kërkesave e inspicientit;
- Mirëmban dhe vë në funksionimin e rregullt ngrohtoren e teatrit në kohën e duhur dhe raporton për çdo mungesë apo mosfunksionim të saj;
- Ruan inventarin dhe veglat e punës me të cilat ishte i ngarkuar, i regjistron ato në librat e regjistrimit dhe mbanë përgjegjësi për to;
- Monton dhe demonton skenografinë në rast të udhëtimeve të shfaqjes dhe siguron që ato mund të transportohen në mënyrë të sigurte;
- Kryen dhe punë të tjera sipas kërkesës së drejtorit të teatrit apo drejtorit për kulturë, rini dhe sport në përputhje me natyrën e punës dhe përgatitjen e tij;
- Për punën e tij i përgjigjet inspicientit, udhëheqësit të njësisë teknike, udhëheqësit artistik dhe drejtorit të teatrit.

Shkollimi i kërkuar: Diplomë e shkollës së mesme.

Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera:

- Të kenë së paku 3 vite përvojë pune aktive në teatër duke dëshmuar përvojën;
- Njohja e punës praktike me përdorimin e veglave të punës së nevojshme për realizim të skenografive.

4. Titulli i vendit të punës: Organizator
Niveli i pagesës: sipas koeficientit 7.0
Numri i ekzekutuesve: 1 (një)
Orari i punës: i plotë, 40 orë në javë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të organizoj mbajtjen e provave dhe sipas kërkesave angazhohet në shfaqje;
- Të hulumtojnë dhe lexojnë materiale apo të ndërmarrin aktivitete fizike dhe intelektuale që ndihmojnë në përgatitjen e rolit të tyre;
- Të diskutojnë dhe organizojnë me kreativitet;
- Të bashkëpunojnë me të tjerët dhe regjisorin;
- Të përformojnë në studio apo lokacion tjetër varësisht nga nevojat që paraqet produksioni;
- Të incizoj zërin varësisht nga nevoja e produksionit;
- Të kujdesen për hapësirën përformuese, kostumet dhe rekuizitat;
- Të studiojnë veprën dhe punojnë në mënyrë krijuese për jetësimin artistik në përpunimin e rolit;
- Të bashkëpunon drejtpërdrejt me regjisorin e shfaqjes;
- Kryen dhe punë të tjera sipas kërkesës së drejtorit të teatrit apo drejtorit për kulturë, rini dhe sport në përputhje me natyrën e punës dhe përgatitjen e tij;
- Për punën e tij i përgjigjen regjisorit, inspicientit, udhëheqësit artistik dhe drejtorit të teatrit.

Shkollimi i kërkuar: Diplomë e shkollës së mesme.

Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera:

- Të kenë së paku tri (3) vjet përvojë pune aktive në Teatër;
- Të dëshmojnë talentin dhe përvojën e tyre para audicionit që e organizon Komisioni profesional;
- Të njohë gjuhën shqipe në nivel të shkëlqyer në të shkruar dhe lexuar (njohja e gjuhëve të huaja përparësi);
- Të ketë aftësi të mira për komunikime ndër njerëzore dhe të jenë të gatshëm të punojë me orar fleksibil të punës;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel);

5. Titulli i vendit të punës: Pëshpëritëse
Niveli i pagesës: sipas koeficientit 7.0
Numri i ekzekutuesve: 1 (një)
Orari i punës: i plotë, 40 orë në javë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Merr pjesë në mbajtjen e provave deri te premiera dhe në repriza sipas kërkesës së regjisorit;
- Të hulumtojnë dhe lexojnë materiale apo të ndërmarrin aktivitete fizike dhe intelektuale që ndihmojnë në përgatitjen e rolit të tyre;
- Të diskutojnë dhe organizojnë me kreativitet;
- Të bashkëpunojnë me të tjerët dhe regjisorin;
- Të incizoj zërin varësisht nga nevoja e produksionit;
- Të studiojnë veprën dhe punojnë në mënyrë krijuese për jetësimin artistik;
- Të bashkëpunon drejtpërdrejt me regjisorin e shfaqjes;
- Kryen dhe punë të tjera sipas kërkesës së drejtorit të teatrit apo drejtorit për kulturë, rini dhe sport në përputhje me natyrën e punës dhe përgatitjen e tij;
- Për punën e tij i përgjigjen regjisorit, inspicientit, udhëheqësit artistik dhe drejtorit të teatrit.

Shkollimi i kërkuar: Diplomë e shkollës së mesme.

Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera:

- Të kenë së paku tri (3) vjet përvojë pune aktive në Teatër;
- Të njohë gjuhën shqipe në nivel të shkëlqyer në të shkruar dhe lexuar (njohja e gjuhëve të huaja përparësi);
- Të ketë aftësi të mira për komunikime nder njerëzore dhe të jenë të gatshëm të punojë me orar fleksibil të punës;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel);

6. Titulli i vendit të punës: Përgjegjës për skenën e të rinjve dhe fëmijëve
Niveli i pagesës: sipas koeficientit 7.0
Numri i ekzekutuesve: 1 (një)
Orari i punës: i plotë, 40 orë në javë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të organizoj mbajtjen e provave dhe sipas kërkesave angazhohet në shfaqje;
- Të hulumtojnë dhe lexojnë materiale apo të ndërmarrin aktivitete fizike dhe intelektuale që ndihmojnë në përgatitjen e rolit të tyre;
- Të diskutojnë dhe organizojnë me kreativitet;
- Të bashkëpunojnë me të tjerët dhe regjisorin;
- Të performojnë në studio apo lokacion tjetër varësisht nga nevojat që paraqet produksioni;
- Të incizoj zërin varësisht nga nevoja e produksionit;
- Të kujdesen për hapësirën përformuese, kostumet dhe rekuizitat;
- Të studiojnë veprën dhe punojnë në mënyrë krijuese për jetësimin artistik në përpunimin e rolit;
- Të bashkëpunon drejtpërdrejt me regjisorin e shfaqjes;
- Kryen dhe punë të tjera sipas kërkesës së drejtorit të teatrit apo drejtorit për kulturë, rini dhe sport në përputhje me natyrën e punës dhe përgatitjen e tij;
- Për punën e tij i përgjigjen regjisorit, inspicientit, udhëheqësit artistik dhe drejtorit të teatrit.

Shkollimi i kërkuar: Diplomë e shkollës së mesme.

Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera:

- Të kenë së paku tri (3) vjet përvojë pune aktive në Teatër;
- Të dëshmojnë talentin dhe përvojën e tyre para audicionit që e organizon Komisioni profesional;
- Të njohë gjuhën shqipe në nivel të shkëlqyer në të shkruar dhe lexuar (njohja e gjuhëve të huaja përparësi);
- Të ketë aftësi të mira për komunikime ndër njerëzore dhe të jenë të gatshëm të punojë me orar fleksibil të punës;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel);

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar.

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:

Procesi i rekrutimit është i paraparë me Ligjin të Punës numër 03/L-212, Ligjin numër 04/L-106 për Teatrot, dhe Udhëzimin Administrativ (MPMS) numër 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik.

Kohëzgjatja e emërimit: Nëpunësit e teatrit që pranohen përmes Konkursit publik, marrin kontrata dy vjeçare me mundësi vazhdimi sipas suksesit dhe angazhimit të treguar në harmoni me Rregulloret e sipër cekura.

Afati i konkursit: Konkursi është i hapur pesëmbëdhjete (15) ditë kalendarike nga data e publikimit (nga 18.06.2020 deri 02.07.2020) në orën 16:00.

Dokumentet e kërkuara:

CV-ja, Diploma mbi kualifikimin e noterizuar, Diplomat e lëshuara nga Institucionet Shkollore jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara (kopje); Vërtetimi për përvojën e punës (kopje); Certifikata që nuk jeni nën hetime (origjinal); Dokumenti i identifikimit (kopje).

Dokumentet e pranuara nuk kthehen.

Paraqitja e kërkesave:

Aplikacionet merren në *Qendrën e Informimit*, kati përdhes në ndërtesën e Komunës së Gjakovës si dhe mund të shkarkohet nga ueb-faqja zyrtare e Komunës së Gjakovës, dhe i plotësuar dorëzohet personalisht në *Zyrën e Pranimit* apo të dërgohen me postë në këtë adresë: *Komuna e Gjakovës, rruga "UÇK" numër 53, 50000 Gjakovë, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Kati III*

-Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.
-Për shkak të numrit të madh të kërkesave, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.